

# RELACION

## PËR

### PROJEKTLIGJIN

#### **PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10304, DATË 15.7.2010 “PËR SEKTORIN MINERAR NE REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i hartimit të këtij projektakti është përmirësimi dhe lehtësimi i procedurave ligjore për shoqëritë që ushtrojnë veprimtari minerare në Republikën e Shqipërisë.

Menaxhimi i veprimtarisë minerare në zbatim të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, ka nxjerrë në pah nevojën e ndryshimeve ligjore.

Amendimet legislative, të përfshira në draftin e projektligjit përfshijnë një sërë shtesash, përmirësimesh dhe riformulimesh, të cilat synojnë përditësimin e tij me zhvillimet e reja në fushën e veprimtarisë minerare.

Nevoja për ndërhyrje në ligjin nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar u kushtëzua nga zbatimi në praktikë i cili evidentoi nevojën për ndryshime të ligjit ekzistues.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Miratimi i këtij projektligji është i planifikuar në programin analitik të projekt akteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2020.

#### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Në këtë projektligj janë vlerësuar t'i jepen zgjidhje disa prej problematikave kryesore të evidentuar ndër vite, siç janë:

- *Ndryshimi i garancisë financiare të investimit për lejet e kërkim zbulimit.* Në ligjin minerar aktual është parashikuar që shoqëritë e licesuara për veprimtarinë e kërkim zbulimit të depozitojnë çdo vit një Garanci financiare për realizimin e programit minimal të punës në vlerë të barabartë me investimit që është parashikuar të kryejë shoqëria për çdo vit. Depozitimi i një vlerë të tillë të garancisë financiare vlerësohet nga shoqëritë minerare si një barrë shumë e rëndë financiare pasi bllokon një pjesë shumë të konsiderueshme të likujditeteve të shoqërisë, të cilat mund të përdoren për të investuar në realizimit e programit minimal të punës së lejes minerare të kërkim-zbulimit. Me uljen e kësaj vlerës së garancisë në 10%, shoqëria ka mundësinë të investoj më shpejt në kohë dhe të përfundoj më shpejt punimet e kërkim zbulimit.
- *Ndryshimi i afatit të lejeve të kërkim zbulimit për grupin e mineraleve ndërtimore.* Aktualisht në ligj është parashikuar se lejet e kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve ndërtimore kanë një afat vlefshmërie 1 vit nga hyrja në fuqi. Nga eksperiencia e shoqërive minerare të licensuara për veprimtarinë e kërkim zbulimit për materialet ndërtimore si dhe nga monitorimi i kryer nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar në këto shoqëri është vënë re se në disa raste kjo kohë (1 vit) është e pamjaftueshme për të përfunduar punimet e kërkim zbulimit. Në draftin e projektligjit është parashikuar që Leja e kërkim-zbulimit të ketë afat vlefshmërie 1 vit nga hyrja në fuqi e saj, me të drejtë shtyrje për një vit, me sipërfaqe jo më shumë se 50% të sipërfaqes fillestare. Për sipërfaqen e mbajtur për vitin e dytë subjekti do të paguaj 150 000 lekë/km<sup>2</sup>, duke i dhënë kështu mundësinë subjekteve të përfundojnë punimet e kërkim zbulimit për pjesën e mbetur.
- *Transferimi i lejeve të dhëna me procedurë konkurruese.* Një nga problemet e vërejtura në zhvillimin e aktivitetit minerar ka qenë pamundësia e transferimit të lejeve minerare të dhëna me procedura konkurruese. Duke marrë në konsideratë dinamikën e ndryshimeve që mund të ketë një shoqëri tregtare gjatë zhvillimit të veprimtarive të ndryshme që ajo mund të zhvillojë (jo vetëm në aktivitetin minerar) është propozuar që të lejohet mundësia e transferimit të lejeve të dhëna me procedurë konkurruese pas një periudhe 5 vjeçare nga data e dhënies së lejes dhe transferohen vetëm pas miratimit paraprak të ministrit.
- *Mundësia e pajisjes me leje minerare të subjekteve pjesëmarrëse në realizimin e projekteve për qëllime publike vendore ose kombëtare.* Në ligjin minerar është parashikuar mundësia e pajisjes me leje shfrytëzimi të

---

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë

karrierave për subjektet të cilat kanë fituar të drejtën e realizimit të projekteve me rëndësi kombëtare apo lokale. Momentalisht kjo e drejtë i jepet vetëm subjektit të krijuar nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore ose subjektit, i cili ka fituar të drejtën e realizimit të projektit me rëndësi kombëtare.

Subjektet të cilat fitojnë të drejtën e realizimit të projekteve me rëndësi kombëtare, mund të jenë specializuar në fushën e ndërtimeve publike por mund të mos jenë të specializuar për të kryer veprimtari minerare. Në kushte të tilla këto subjekte nënkontraktojnë shoqëri të tjera për të kryer këtë veprimtari. Për këtë arsye është menduar që në ligjin minerar të parashikohet që Leja e shfrytëzimit të karrierave për qëllime publike vendore ose kombëtare t'i jepet edhe subjekteve pjesëmarrëse në realizimin e projektit.

- *Rastet kur vazhdimi i shfrytëzimit të një zone minerare bie ndesh me projekte të tjera që kanë interes publik.* Në ligjin minerar është parashikuar e drejta e zgjatjes së lejes minerare të shfrytëzimit në rastet kur zotëruesi i saj i ka plotësuar detyrimet financiare, ka kryer investimet e parashikuara në programin e punës, në përputhje me lejen e dhënë, dhe paraqet një program pune shtesë, bindës për ministrin. Duke qenë se lejet minerare kanë afat 25 vjeçar, gjatë kësaj periudhe nga institucione përkatëse mund të planifikojnë të zhvillojnë projekte që kanë interes publik. Për këtë arsye në projektligj përveç kushteve të tjera për zgjatjen e lejes minerare, u parashikua se zgjatja e afatit miratohet kur vazhdimi i shfrytëzimit nuk bie ndesh projekte të tjera që kanë interes publik.
- *Pezullimi i përkohshëm i lejes së shfrytëzimit me karrierë të mineraleve dhe grupit të mineraleve ndërtimore.* Ligji aktual minerar i jep të drejtën subjekteve që zotërojnë Leje shfrytëzimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, të pezullojnë përkohësisht veprimtarinë e shfrytëzimit në zonën e lejuar. Kjo e drejtë nuk është e parashikuar subjekteve që zotërojnë Leje shfrytëzimi me karrierë të mineraleve dhe grupit të mineraleve ndërtimore. Tregu i materialeve ndërtimore ka pasur herë pas here luhatje, zotëruesit e lejeve minerare të shfrytëzimit me karrierë të mineraleve dhe grupit të mineraleve ndërtimore kanë qenë të detyruar të vazhdojnë prodhimin dhe të krijojnë një stok materiali duke qenë se ligji minerar nuk kishte të parashikuar të drejtën e pezullimit të përkohshëm të veprimtarisë për këtë grup. Sa më sipër, në projekt ligj u parashikua e drejta e pezullimit të përkohshëm të veprimtarisë së shfrytëzimit në zonën e lejuar.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutë së Republikës së Shqipërisë.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Projektligji nuk përfron asnjë akt komunitar dhe nuk lidhet me zbatimin e ndonjë *acquis* specifik të BE-së.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Ky projekt-akt konsiston në miratimin e ndryshimeve të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, në mënyrë që të përmirësohen dhe lehtësohen procedurat ligjore për shoqëritë që ushtrojnë veprimtari minerare në Republikën e Shqipërisë.

Amendimet legislative, të përfshira në draftin e projektligjit përfshijnë një sërë shtesash, përmirësimesh dhe riformulimesh, të cilat synojnë përfitësimin e tij me zhvillimet e reja në fushën e veprimtarisë minerare.

Në Neni 1, janë parashikuar saktësime të disa përkufizimeve të nenit 2 të ligjit

- Në pikën 19, pas fjalës “nuk lejohet” shtohen fjalët “kryerja e veprimtarive minerare për lejet ekzistuese dhe”, duke ndaluar kështu punimet minerare në zonat e rrezikshme edhe për lejet ekzistuese.
- Në pikën 23, pas fjalës “mineralit” shtohen fjalët “të thatë”, për arsye se në shitjen e mineralit, sipas peshës, hiqet lagështia.
- Në pikën 32, pas fjalëve "Kadastra minerare" shtohen fjalët “krijohet nga heqja e sipërfaqes nga fondi pyjor e kullësor dhe” dhe pas fjalëve “zonat e lejuara minerare” shtohen fjalët “të cilat regjistrohen pas heqjes nga fondi pyjor e kullësor.”. Kjo shtesë saktëson momentin kur zona regjistrohet në Kadastrën minerare.
- Në pikën 37, fjalët “çdo vit” shfuqizohen, duke qenë se me ligjin 134/2014 ka ndryshuar pika 3 e nenit 31, dhe me këtë projektligj ndryshon pika 2, e nenit 31 të ligjit.

Në nenin 2, është bërë një saktësim i nenit 3, fjalia “Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, shteti, për efekt të zbatimit të këtij ligji, përfaqësohet nga ministri.” zëvendësohet me fjalinë “Shteti për efekt të zbatimit të këtij ligji përfaqësohet nga ministri përgjegjës për veprimtarinë minerare.”.

Në nenin 3, është bërë saktësim i pikës 2, të nenit 5.

Në nenin 4, janë bërë ndryshime te nenit 8. Ky ndryshim konsiston në këshillimin me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, pyjet, tokën bujqësore, trashëgiminë kulturore, turizmin e mbrojtjen dhe njësitë e qeverisjes vendore përkatëse, gjatë hartimit të programit 3 vjeçar.

Në nenin 5, janë bërë disa saktësime të nenit 9.

- Në pikën 1, paragrafi i parë, pas fjalës “teknik” shtohet fjala “mjedisor”.
- Në pikën 2/b fjalët “nuk i ka shndërruar në leje shfrytëzimi, edhe pse ka zbuluar rezerva minerare me interes publik” zëvendësohen me fjalët “ka realizuar punimet e investimit sipas projektit, ka zbuluar rezerva me interes ekonomik, ka dorëzuar raport gjeologjik, por nuk ka kërkuar për ta shndërruar në leje shfrytëzimi.”
- Në paragrafin e fundit të pikës 3, fjalët “deri në një vit” zëvendësohen me fjalët “ai i përcaktuar në pikën 1, të nenit 14”

Në nenin 6, janë bërë ndryshime të nenit 13.

- Në pikën 4/b, fjalët “së paku 90 për qind” zëvendësohen me “deri në 90 për qind”. Ky ndryshim i jep mundësinë subjekteve minerare të cilat nuk kanë përfunduar punimet në më shumë se 90% të sipërfaqes së lejes së kërkim zbulimit në fund të afatit të lejes, të mbajnë një sipërfaqe më të madhe se 10%.
- Në pikën 4/c, fjalët “fillimit të vitit të katërt të” zëvendësohen me “zgjatjes së”, për efekt saktësimi.

Në nenin 7 bëhen ndryshime të nenit 14.

- Në pikën 1 fjalët “Afati i vlefshmërisë mund të zgjatet 2 herë, me kërkesë të zotëruesit të lejes. Çdo zgjatje ka afat 1-vjeçar.” zëvendësohen me fjalët “Afati i vlefshmërisë mund të zgjatet 1 herë, me kërkesë të zotëruesit të lejes, për një periudhë 1-vjeçare.”
- Duke qenë se në këtë projektligj vlera e garancisë së investimit për lejet e kërkim zbulimit është parashikuar 10% e vlerës së investimit (neni 20, pika 1 e projektligjit), në pikën 4, fjalia “Në rast se nuk shpenzohet vlera e përcaktuar, atëherë pjesa e mbetur i kalon Buxhetit të Shtetit.”, shfuqizohet.

Në nenin 8, është parashikuar ndryshim i pikës 2, të nenit 16. Në ligjin mineralar është parashikuar e drejta e zgjatjes së lejes minerare të shfrytëzimit në rastet kur zotëruesi i saj i ka plotësuar detyrimet financiare, ka kryer investimet e parashikuara në programin e punës, në përputhje me lejen e dhënë, dhe paraqet një program pune shtesë, bindës për ministrin. Duke qenë se lejet minerare kanë afat 25 vjeçar, gjatë kësaj periudhe nga institucione përkatëse mund të planifikojnë të zhvillojnë projekte që kanë interes publik. Për këtë arsye në projektligj përveç kushteve të tjera për zgjatjen e lejes minerare, u parashikua se zgjatja e afatit miratohet kur vazhdimi i shfrytëzimit nuk bie ndesh projekte të tjera që kanë interes publik.

Në projektligj është ndryshuar afati për raportimet e subjekteve minerare pranë strukturave përgjegjëse nga raportim çdo 3 muaj në raportim çdo 6 muaj kalendarik.

Në nenin 11, është parashikuar ndryshim i nenit 19, pika 4. Aktualisht në ligj është parashikuar se lejet e kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve ndërtimore kanë një afat vlefshmërie 1 vit nga hyrja në fuqi. Nga eksperiencia e shoqërive minerare të licensuara për veprimtarinë e kërkim zbulimit për materialet ndërtimore si dhe nga monitorimi i kryer nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar në këto shoqëri është vënë re se në disa raste kjo kohë (1 vit) është e pamjaftueshme për të përfunduar punimet e kërkim zbulimit. Në draftin e projektligjit është parashikuar që Leja e kërkim-zbulimit të ketë afat vlefshmërie 1 vit nga hyrja në fuqi e saj, me të drejtë shtyrje për një vit, me sipërfaqe jo më shumë se 50% të sipërfaqes fillestare. Për sipërfaqen e mbajtur për vitin e dytë subjekti do të paguaj 150 000 lekë/km<sup>2</sup>, duke i dhënë kështu mundësinë subjekteve të përfundojnë punimet e kërkim zbulimit për pjesën e mbetur.

Në nenin 12, është parashikuar ndryshim i nenit 20, pika 1/b, duke përcaktuar si një detyrim të subjektit mineralar paraqitjen në strukturën përgjegjëse në përfundim të afatit të vlefshmërisë së lejes, të raportit gjeologjik tekniko – ekonomik, me një informacion të detajuar mbi punimet e kryera në zonën e lejuar, investimet e realizuara, rezultatet e provave të marra, sasinë e rezervave dhe materialin grafik ilustrues.

Në nenin 13 dhe 14 të projektligjit janë parashikuar ndryshime nenit 23 dhe 24, të ligjit. Në ligjin mineralar është parashikuar mundësia e pajisjes me leje shfrytëzimi të karrierave për subjektet të cilat kanë fituar të drejtën e realizimit të projekteve me rëndësi kombëtare apo lokale. Momentalisht kjo e drejtë i jepet vetëm subjektit të krijuar nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore ose subjektit, i cili ka fituar të drejtën e realizimit të projektit me rëndësi kombëtare.



Subjektet të cilat fitojnë të drejtën e realizimit të projekteve me rëndësi kombëtare, mund të jenë specializuar në fushën e ndërtimeve publike por mund të mos jenë të specializuar për të kryer veprimtari minerare. Në kushte të tilla këto subjekte nënkontraktajnë shoqëri të tjera për të kryer këtë veprimtari. Për këtë arsye është menduar që në ligjin minerar të parashikohet që Leja e shfrytëzimit të karrierave për qëllime publike vendore ose kombëtare t'i jepet edhe subjekteve pjesëmarrëse në realizimin e projektit.

Në nenin 15 janë bërë dy saktësime të nenit 24, të ligjit.

Në nenin 16 janë bërë disa ndryshime të nenit 25, të ligjit. Ligji aktual minerar i jep të drejtën subjekteve që zotërojnë Leje shfrytëzimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, të pezullojnë përkohësisht veprimtarinë e shfrytëzimit në zonën e lejuar. Kjo e drejtë nuk është e parashikuar subjekteve që zotërojnë Leje shfrytëzimi me karrierë të mineraleve dhe grupit të mineraleve ndërtimore. Tregu i materialeve ndërtimore ka pasur herë pas here luhatje, zotëruesit e lejeve minerare të shfrytëzimit me karrierë të mineraleve dhe grupit të mineraleve ndërtimore kanë qenë të detyruar të vazhdojnë prodhimin dhe të krijojnë një stok materiali duke qenë se ligji minerar nuk kishte të parashikuar të drejtën e pezullimit të përkohshëm të veprimtarisë për këtë grup. Sa më sipër, në projekt ligj u parashikua e drejta e pezullimit të përkohshëm të veprimtarisë së shfrytëzimit në zonën e lejuar, si dhe kushtet kur i miratohet pezullimi subjektit minerar.

Në nenin 18, është bërë ndryshim i nenit 29 të ligjit, duke parashikuar se në rast se subjekti që kërkon të përfitojë një të drejtë minerare nuk ka eksperience në këtë fushë, ai mund të bashkëpunim me një subjekt tjetër me përvojë në fushën minerare.

Gjithashtu në pikën 3, fjalët “dhe "ë”” shfuqizohen, pasi kjo pike është shfuqizuar nga ligji nr. 134/2014.

Në nenin 19, janë bërë disa saktësime në nenin 30 të ligjit.

Në nenin 20, është parashikuar ndryshim i pikës 2, të nenit 31, duke përcaktuar se garancia e investimit është 10% e vlerës së investimit të vitit me investim maksimal.

Në ligjin minerar aktual është parashikuar që shoqëritë e licesuara për veprimtarinë e kërkim zbulimit të depozitojnë çdo vit një Garanci financiare për realizimin e programit minimal të punës në vlerë të barabartë me investimit që është parashikuar të kryejë shoqëria për çdo vit. Depozitimi i një vlerë të tillë të garancisë financiare vlerësohet nga shoqëritë minerare si një barrë shumë e rëndë financiare pasi bllokun një pjesë shumë të konsiderueshme të likujditeteve

---

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë

të shoqërisë, të cilat mund të përdoren për të investuar në realizimit e programit minimal të punës së lejes minerare të kërkim-zbulimit. Me uljen e kësaj vlerës së garancisë në 10%, shoqëria ka mundësinë të investoj më shpejt në kohë dhe të përfundoj më shpejt punimet e kërkim zbulimit.

Në nenin 21, është parashikuar ndryshim i pikës 2, të nenit 40, ku pas fjalës “mineralit” shtohen fjalët “të thatë”, për arsye se në shitjen e mineralit, sipas peshës, hiqet lagështia.

Në nenin 22 është parashikuar ndryshim i nenit 41, “Transferimi i të drejtave minerare nga zotëruesi”, të ligjit, duke qenë se një nga problemet e vërejtura në zhvillimin e aktivitetit mineral ka qenë pamundësia e transferimit të lejeve minerare të dhëna me procedura konkurruese. Duke marrë në konsideratë dinamikën e ndryshimeve që mund të ketë një shoqëri tregtare gjatë zhvillimit të veprimtarive të ndryshme që ajo mund të zhvillojë (jo vetëm në aktivitetin mineral) është propozuar që të lejohet mundësia e transferimit të lejeve të dhëna me procedurë konkurruese pas një periudhe 5 vjeçare nga data e dhënies së lejes dhe transferohen vetëm pas miratimit paraprak të ministrit.

Në nenin 23 është parashikuar ndryshim i pikës 2, të nenit 57. Me këtë ndryshim, për të drejtat minerare të fituara në bazë të ligjit nr. 7796, datë 17.2.1994 "Ligji mineralar i Shqipërisë", zotëruesit të lejes së shfrytëzimit të grupit të mineraleve metalore i jepet e drejta e shtyrjes së afatit të vlefshmërisë dy herë. Shtesa e parë me të drejtë shtyrje 10 vjet dhe shtesa e dyte me te drejte shtyrje 5 vjet, me kusht që kjo shtyrje të kërkohet çdo here të paktën 365 ditë kalendarike para përfundimit të afatit të vlefshmërisë, ndërsa zotëruesi i lejes së shfrytëzimit të grupit të mineraleve ndërtimore ka të drejtën e shtyrjes së afatit të vlefshmërisë tre herë. Shtesa e parë me të drejte shtyrje 10 vjet, shtesa e dytë me të drejtë shtyrje 10 vjet dhe shtesa e tretë me të drejtë shtyrje 5 vjet, me kusht që kjo shtyrje të kërkohet çdo herë të paktën 180 ditë kalendarike para përfundimit të afatit të vlefshmërisë.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij ligji.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**



Projektligji është hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Ky projektligj nuk ka efekte financiare në buxhetin e shtetit.

**MINISTRI**

**Belinda Balluku**